

# *“Prishtina Ime”*

## *Konkursi i Pikturës dhe Fotografisë*

*Si duket Prishtina juaj?*

*Cila është Prishtina juaj?*

*Çfarë është gjëja që e doni më së shumti në Prishtinë? ...*

*Ejani merrni pjesë edhe ju në konkurs, me fotografitë dhe pikturat që i keni bërë.*



**Datat e aplikimit : 31 maj - 09 qershor 2016**

**Vendi i aplikimit**



**Yunus Emre Enstitüsü**  
Qendra Kulturelle Turke  
Prishtinë



Adresa: Rr. “Mujo Ulqinaku”, nr.50, Pejton, 10000 Prishtinë,  
Telefoni: 038 609 415  
E-mail: [pristine@yee.org.tr](mailto:pristine@yee.org.tr) - Web: [www.yee.org.tr/kosova-pristine](http://www.yee.org.tr/kosova-pristine)



/yeepristine



100VA-PR

**QENDRA KULTURORE E FËMIJËVE**



## Konkursi i Pikturës dhe Fotografisë “Prishtina Imë”



### Si duket Prishtina juaj? Cila është Prishtina juaj?

Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës dhe Yunus Emre Enstitüsü Qendra Kulturore Turke në Prishtinë, organizojnë konkurs të pikturës dhe fotografisë me rastin e “11 Qershorit Ditës së Prishtinës”. Ejani merrni pjesë edhe ju në konkurs, me fotografitë dhe pikturat që i keni bërë. Për të marr pjesë në konkursin me shpërblim të temës “Prishtina Imë” mjafton që t’i dërgoni pikturat dhe fotografitë në lidhje me Prishtinën.

### Kushtet për pjesëmarrje në konkurs:

- Tema e konkursit është “Prishtina Imë”. Çfarë kuptimi ka Prishtina për ju? Pse e doni Prishtinën? Çfarë është gjëja që e doni më së shumti në Prishtinë? (Me anë të fotografisë ose pikturës që do ta bëni mundohuni tu jepni përgjigje këtyre pyetjeve).
- Në konkurs mund të marrin pjesë me një pikturë ose fotografi nxënësit e klasave të 5-të, 6- të, 7-të, 8-të dhe 9-të. - Çdo nxënës mund të merr pjesë në konkurs me vetëm një pikturë/fotografi
- Mund të përdoret çdo lloj produkt i ngjyrave për pikturë. (Ngjyra të ujit, tempera, ngjyra të drurit, e të ngjashme).
- Nuk ka ndonjë kufizim rreth dimensioneve të fotografive dhe pikturave.
- Fotografitë duhet të dorëzohen në formë të shtypur kurse pikturat duhet të dorëzohen të vendosura në korniza ose të ngjitura në një karton të fortë dhe të trashë.
- Fotografitë dhe pikturat që do të marrin pjesë në konkurs do të përzgjidhen nga ana e jurisë që do të formohet nga Qendra Kulturore e Fëmijëve në Prishtinë dhe Yunus Emre Enstitüsü Qendrës Kulturore Turke në Prishtinë.
- Nxënësve që do të fitojnë tre vendet e para në fushën e fotografisë do tu dhurohen aparat për fotografi të firmës “Sony”, kurse nxënësve që do të fitojnë tre vendet e para në fushën e pikturës do tu dhurohen 40 ngjyra dhe seti i brushave si dhe tavolinë për pikturim dhe këmbalecë piktori.
- Ndërsa 15 fotografitë dhe pikturat të cilat nuk do të mund t’i fitojnë vendet e para por që janë zgjedhur nga ana e jurisë për ekspozim, do të ekspozohen në Yunus Emre Enstitüsü Qendrën Kulturore Turke Prishtinë. - Veprat që do të fitojnë vendet e para, do të shpallen në faqet e “facebook-ut” të Qendrës Kulturore të Fëmijëve të Prishtinës dhe Yunus Emre Enstitüsü Qendrës Kulturore Turke Prishtinë si dhe në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.
- Shpërblimet e konkurruesve që do të fitojnë vendet e para, do tu ndahen me datën 11 Qershor 2016 në Yunus Emre Enstitüsü. Në të njëjtën ditë do të ekspozohen edhe 15 fotografitë dhe pikturat tjera.

- Pikturat/fotografite duhet të dorëzohen mes datave 31.05.2016 – 09.06.2016 duke filluar nga ora 9.00 – 16.00 në “Yunus Emre Enstitüsü Qendra Kulturore Turke në Prishtinë”.
- Në fund të këndit të djathtë në pjesën e prapme të pikturave/fotografive duhet tu shënohet në mënyrë të qartë; emri, mbiemri, klasa, shkolla dhe numri i telefonit. Pikturat e nxënësve nuk do të merren në vlerësim nëse informatat e tyre do të jenë të mangëta.
- Të dhënat që u përkasin konkurruesve do të përdoren vetëm për qëllime të konkursit.

Ju dëshirojmë suksese gjithë pjesëmarrësve!

Adresa ku mund ti sillni punimet tuaja:

**Yunus Emre Enstitüsü Qendra Kulturore Turke në Prishtinë.**

**Adresa : Lagjja Pejton, Rr. Mujo Ulqinaku nr 50, 10000 Prishtinë/ Kosovë**

**Telefoni: 038 609 415,**

**email: [pristine@yee.org.tr](mailto:pristine@yee.org.tr) ose [pristineye@gmail.com](mailto:pristineye@gmail.com)**

**/yeepristine /yeepristine**